



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të shkresës së ardhur nga Ministria e Drejtësisë, regjistruar me numër rendor 35 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 6276 Prot., datë 06.12.2023, me anë të së cilës kërkonti procesverbalin e mbledhjeve të ish-KLD dhe listëprezencën e personave që kanë marrë pjesë në mbledhje, me funksionin përkatës, për miratimin e vendimit nr. 7, datë 08.02.1996 dhe vendimi nr. 8, datë 23.08.1996, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me periudhën për të cilën kërkonti informacion dhe dokumentacion, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD-ja e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, siç citohet edhe nga ana juaj.

Organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo edhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, aktualisht disponon vetëm Regjistrin Themeltar të Ministrisë së Drejtësisë, ku janë të pasqyruara vendimi nr. 7 datë 08.02.1996 dhe vendimi nr. 8 datë 23.08.1996 ndaj znj. {...}.

Sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon dhe administron dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj, i cili mund të jetë i administruar nga institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!